



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**K R Y E T A R I**

*Adresa: Rruga "Abdi Toptani", nr. 1, Tiranë; Tel-Fax: 068 20 80770*  
*E-mail: [bleskaj@klsh.org.al](mailto:bleskaj@klsh.org.al); Web-site: [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)*

Nr. \_\_\_ Prot.

Tiranë, më21\_/12/2018

**V E N D I M**  
**Nr. 236 Datë 21.12.2018**

**PËR**  
**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**  
**"MENAXHIMI I PËRPUNIMIT TË MBETJEVE TË NGURTA NË IMPIANTIN E**  
**BASHKISË FIER"**

Në zbatim të planit vjetor 2018, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të përmbushjes së funksionit të tij kushtetues, zbatimit të Udhëzimeve dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI, EUROSAI etj.), sipas shkresës nr. 440/7, datë 24.05.2018, Program auditimi, ndërmori auditimin e performancës me temë "Menaxhimi i përpunimit të mbetjeve të ngurta në impiantin e Bashkisë Fier".

Auditimi i performancës "Menaxhimi i përpunimit të mbetjeve të ngurta në impiantin e Bashkisë Fier" vjen në një moment që situata e trajtimit të mbetjeve në Bashkinë Fier ka marrë një rrugë të caktuar drejt zgjidhjes së një problemi madhor, jo vetëm për Bashkinë Fier, siç është ai i trajtimit dhe menaxhimit të mbetjeve urbane, i cili vazhdon prej mëse 20 vjetësh.

Ashtu si në të gjithë Shqipërinë, edhe në territorin e Bashkisë Fier, administrimi i mbetjeve është në një nivel shumë të ulët. Me sisteme për grumbullimin e mbetjeve të ngurta janë pajisur vetëm qytetet, por jo zonat rurale që e rrethojnë. Në këtë Qark praktikohet shumë pak riciklimi, pasi vetëm bëhet ndarje e disa përbërësve si: bidonët plastikë, mbetje hekuri, etj., nga punonjës informale, që e kanë veçimin, grumbullimin e shitjen e tyre një mjet jetese. Kryesisht, mbetjet asgjësohen në vend-grumbullimet e mbetjeve. Si në Bashkinë Fier por edhe në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, me disa përjashtime të vogla (impianti Elbasan, landfill-et e Sharrës dhe Bushatit, etj.), nuk ka vend depozitime të planifikuara siç duhet.

KLSH, nëpërmjet veprimtarisë së saj audituese (auditime përputhshmërie, financiare, të performancës dhe të IT-së) ka pasur në qendër të vëmendjes forcimin e përgjegjshmërisë e llogaridhënies publike duke thelluar luftën kundër korrupsionit në institucionet publike nëpërmjet masave rekomanduese për përmirësime ligjore, organizative, shpërbllim dëmi, administrative, disiplinore dhe kallëzime penale.

Iniciativa për një impiant për djegien e mbetjeve dhe prodhim të energjisë ka qenë prej vitesh një alternativë potenciale dhe mjaft e diskutueshme në vend. Falë përmirësimeve teknologjike të kohëve të fundit kjo teknologji ka njohur një përdorim të gjerë në vendet e BE-së, që vjen menjëherë pas procesve të ripërdorimit dhe riciklimit. Sipas studimit të fizibilitetit, ky projekt konsiderohet potencialisht i realizueshëm si nga pikëpamja teknike, ekonomike dhe ajo mjedisore. Projekti ka gjetur mbështetje institucionale në nivel qendror dhe lokal si një zgjidhje e qëndrueshme për menaxhimin e mbetjeve në përputhje me politikën kombëtare për menaxhimin e mbetjeve, kuadrin ligjor kombëtar dhe standartet ndërkombëtare.

Nisur nga fakti se deri vonë trajtimi i mbetjeve kryhej në mënyrë primitive dhe nëpërmjet incineratorëve me teknologji të vjetëruar dhe me funksionim të dobët, opinioni publik vazhdon të jetë skeptik dhe kjo vjen gjithashtu nga mungesa e njohurive për teknologjitë e reja në këtë fushë. Ky projekt është një hapi rëndësishëm për përmbushjen e objektivave kombëtare dhe progresi drejt atyre ndërkombëtare sipas direktivave për mbetjet, si parakusht për anëtarësimin e Shqipërisë në BE. Projekti vjen si propozim i pakërkuar dhe si një nevojë emergjente e Qarkut Fier për të zgjidhur në mënyrë të qëndrueshme problematikën e sektorit të menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane. Projekti mbështetet në një skemë Partneriteti Publik Privat, nëpërmjet të cilit synohet të përmbushen objektivat afatshkurtër dhe afatgjatë të menaxhimit të mbetjeve në nivel vendor.

Subjekt i këtij auditimi ishin institucionet: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, si përgjegjëse për formulimin e strategjisë, legjislacionit, përgatitjen e projekteve të menaxhimit të mbetjeve, dhënien e lejeve për inspektimin në nivel qendror dhe vendor, etj.; Agjencia Kombëtare e Mjedisit, e cila ka ndjekur dhe vazhdon të ndjekë procesin e pajisjes me leje mjedisore të incineratorit dhe landfillit, si dhe ka ndjekur procedurat e konsultimit me publikun; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si përgjegjëse për planifikimin dhe përgatitjen e projekteve të menaxhimit të mbetjeve në nivel qendror dhe vendor; Bashkia Fier si përfituesja e këtij projekti dhe si njësi vendore përgjegjëse për realizimin dhe ndjekjen në vijim të tij.

Me qëllim mbledhjen e informacioneve të nevojshme, grupi i auditimit përveç konsultimit të dokumentacionit fizik dhe elektronik të disponuar ka realizuar takime të shpeshta dhe konsulta me specialistët e subjekteve nën auditim, intervista, vëzhgime etj. Grupi i auditimit ka konsultuar gjithashtu, raporte dhe vlerësime të publikuara nga organizata, apo eksperiencia ndërkombëtare mbi menaxhimin e mbetjeve dhe në mënyrë specifike mbi futjen në skemën e menaxhimit të mbetjeve të incineratorëve.

Për shkak të ndjeshmërisë së lartë publike nga ndikimi i menaxhimit të mbetjeve në jetën e përditshme dhe në shëndetin e qytetarëve, alternativa e përzgjedhur për menaxhimin e mbetjeve urbane ka një rëndësi të veçantë. Fokusi i këtij auditimi ishte analiza e performancës së strukturave përgjegjëse për hartimin dhe implementim e

projektit të ndërtimit të incineratorit për djegien e mbetjeve urbane në Bashkinë Fier dhe landfillin për groposjen e hirit të mbetur nga djegia e mbetjeve.

Pas përfundimit të punës paraprake audituese u dërgua Programi i Auditimit të Performancës me shkresën nr. 440/7, datë 24.05.2018. Në përfundim të fazës së terrenit, e cila zgjati jashtë parashikimit për shkak të kalimit të dosjes dhe ndjekjes së projektit nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit tek Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe zhvendosjes së godinës së kësaj të fundit në kohën që kryhej auditimi, iu dërgua Projekt-Raporti i auditimit subjekteve të audituara: Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën 440/8, datë 18.11.2018, Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit, me shkresën nr. 440/9, datë 18.11.2018, Bashkisë Fier me shkresën nr. 440/10, datë 18.11.2018, dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit me shkresën nr. 440/11, datë 18.11.2018. Asnjë nga institucionet e përfshira në auditim nuk dërgoi pranë KLSH-së observacione për Projekt-Raportin e Auditimit.

Në përfundim, pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projekt-vendimin e paraqitur nga grupi i auditimit të Departamentit të Auditimit të Performancës, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Drejtorisë së Standardeve, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të nenit 10 dhe 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

### **K O N K L U D O V A:**

Mungesa e një studimi të mirëfilltë për zgjedhjen e sheshit se ku do të vendoset incineratori është një nga shkaqet kryesore të përplasjeve midis palëve kontraktore dhe qytetarëve që duhet të ishijn zgjidhur që në momentin e kryerjes së këtij studimi, i cili duhet të ishte i diskutueshëm me çdo banor.

Kompania fituese konçesionare e riciklimit të mbetjeve në Fier, është regjistruar si operator për këtë shërbim në QKL 15 ditë pas shpalljes së tenderit, fakt ky i denoncuar publikisht në median e shkruara si dhe atë online. “Integrated Technology Service ShPK” është pajisur me Licencë NZ. 6917/3, datë 31.03.2016, me drejtues ligjor Klodian Zoto me klasifikim licence A, veprim I cili bie në kundërshtim me VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për miratimin dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, lidhja 4, pasi kategoria A i takon punimeve (0-20milion lekë), ndërkohë që kjo shoqëri duhet të kishte kategorinë F (401 – 800 milionë lekë), pasi vlera e kontratës është 28.000.000€ pa tvsh, në të tilla kushte ky Operator Ekonomik nuk e ka kapacitetin e nevojshëm për të kryer këtë investim.

Menaxhimi aktual i mbetjeve urbane me Dampën ekzistuese, që nuk i respekton standardet mjedisore kombëtare nuk sjell asnjë përfitim ekonomik. Duke qenë se kostot sociale e mjedisore të kësaj alternative janë afërsisht minus 54 milion Euro do të thotë se renditet si alternativa e fundit dhe më e padëshiruar. Alternativa e Landfillit të thjeshtë, ndryshe nga dampa aktuale respekton normat dhe standardet mjedisore të vendit tonë. Megjithatë edhe kjo alternativë nuk sjell përfitime në të

ardhura ekonomike, por sjell vetëm përfitime nga shmangia e dëmeve sociale e mjedisore. Shmangia e këtyre dëmeve bën që Vlera Totale Neto kjo alternativë të jetë më e mirë se alternativa e dampës dhe të jetë në vend të tretë përse i përket renditjes së alternativave. Metoda e Inceneratorit në këtë renditje është metoda e dytë më e mirë. Në një situatë tjetër si për shembull në një Bashki me një popullsi disa herë më të madhe që do të thotë disa herë më shumë mbetje, ajo mund të zinte edhe vendin e parë, pasi vetë kjo metodë ka nevojë për një sasi shumë të madhe mbetjesh që të mund të prodhojë më shumë energji dhe që mund të gjenerojë më shumë të ardhura. Kjo metodë, ashtu si metoda e Landfillit të thjeshtë dhe atij me riciklim respekton normat kombëtare të mjedisit. Sipas analizës së bërë në përlogaritjen e Vlerës Aktuale Neto, kjo metodë gjeneron të ardhura nga shitja e energjisë, si edhe nga shmangia e dëmeve sociale e mjedisore. Duhet theksuar, se edhe pse Vlera Totale Neto është negative në këtë rast, në një rast tjetër kjo metodë duhet marrë në konsideratë. Metoda e Landfillit me riciklim, e cila nga Analiza Kosto-Përfitim renditet si metoda më e përshtatshme për trajtimin e mbetjeve urbane në Bashkinë e Fierit është një metodë gjerësisht e përhapur sot në Europë dhe në vendet e zhvilluara së bashku me metodën e Inceneratorit. Kjo metodë përveç se respekton të gjitha normat social mjedisore do t'i sillte investitorit edhe rreth 32 milion Euro përfitime dhe të ardhura në 20 vjet. Përfitimet këtu janë kaq të larta, sepse shitjet nga kompostimi dhe materialet e riciklueshme, por edhe shmangia e dëmeve sociale e mjedisore arrijnë të tejkalojnë kostot totale çka është edhe qëllimi kryesor në përzgjedhjen e alternativës më të mirë për t'u aplikuar.

Mendimi i shprehur nga DRM Fier gjatë procesit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe pajsjes me Leje Mjedisore nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit është i paqartë e kontradiktor. Nuk mund të konkludohet, nëse ky institucion është apo jo dakort me zhvillimin e projektit, duke qenë se DRM shprehet parimisht dakort, pavarësisht se ka mendim negativ për projektin në fjalë. DRM nuk ka bërë një analizë profesionale e teknike nëpërmjet ekspertëve të saj vendorë që ka në përbërje, në lidhje me zhvillimin e këtij aktiviteti dhe ndikimet e tij, qofshin ato pozitive apo negative.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe Bashkia si tre institucionet kryesore të përfshira në projektin e ndërtimit të inceneratorit nuk kanë kryer asnjë studim për vlerësimin e përzgjedhjes së alternativës më të mirë për zgjidhjen e një problemi shumë të nxehtë prej vitesh, sic është ai i menaxhimit të mbetjeve urbane. Nisur nga Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve, e cila përcakton opsionin më të mirë për trajtimin e tyre, ku djegia e mbetjeve me qëllim përfitimin e energjisë gjendet në shkallën e parafundit të piramidës së trajtimit të mbetjeve, e cila fillon me parandalimin e krijimit të mbetjeve duke vijuar me minimizimin, ripërdorimin, riciklimin dhe më tej me rigjenerimin e energjisë, për ta mbyllur me hedhjen ose depozitimin e tyre në landfill. Vënia në jetë e këtij projekti i kalon të gjithë hapat në majë të piramidës për ta filluar direkt me djegien e tyre me qëllim rigjenerimin e energjisë. Ky projekt vë në pikëpyetje hartimin e miratimit të Strategjisë Kombëtare të Mbetjeve dhe qëllimin për tu vënë në jetë e për tu mbështetur në të kur ndërmerren hapa të tillë si projekti në fjalë. Askush nuk i ka kushtuar rëndësi analizës sa më sipër, asnjë nga institucionet që ligji i ngarkon me përfshirjen e tyre për dhënien e mendimeve nga ekspertët që kanë në dispozicion me qëllim e përfaqësimit të interesit të qytetarëve në zgjedhjen e alternativës më të mirë.

Alternativa e incineratorit është marrë e mirëqenë dhe nuk ka hasur në asnjë lloj rezistence nga institucionet. Asnjë institucion nuk ka kërkuar të dhëna më tepër për tu bindur që po zgjidhet alternativa e duhur duke u mbështetur në idenë se duhet një zgjidhje e shpejtë për një problem të madh dhe në idenë se alternativa me këtë projekt është më e mirë se ajo çfarë kemi deri tani. Institucionet që ligji i ngarkon më detyrën për të dhënë mendimin e tyre e për të qenë pjesë e projekteve që zhvillohen në territorin e tyre, janë mjaftuar me analizën e VNM-së së projektit, e cila si alternativa ngre në fakt vetëm dy; alternativa me projekt dhe alternativa pa projekt, duke i mbyllur kështu derën çfarëdolloj alternative tjetër.

Bashkia Fier, si organi më i lartë i pushtetit vendor në Qarkun e Fierit nuk ka dhënë asnjë mendim në lidhje me ndërtimin e incineratorit për djegien e mbetjeve në Fier dhe për atë të ndërtimit të landfillit. Nuk ka asnjë mendim të shprehur nga institucionet zyrtare lokale për ndërtimin e landfillit, pranë impiantit të djegies.

Gjatë gjithë procedurave të zhvilluara për fazën e ndërtimit të të dy projekteve, impianti i incenerimit dhe landfilli për depozitim të hirit, janë kryer gjithsej dy dëgjesa publike, madje në njërin nuk ka patur banorë, por vetëm pjesëmarrës nga institucione të ndryshme. Personat që kanë marrë pjesë në mbledhje me statusin e banorëve lokalë nuk kanë pranuar të firmosin për pjesëmarrjen e tyre me paqartësinë, nëse kjo firmë nënkuptonte dakortësi nga ana e tyre në lidhje me zhvillimin e projekteve. Banorët kanë protestuar kundër zhvillimit të projekteve të incineratorit dhe landfillit. Bashkia Fier nuk ka qenë iniciatore e asnjë mbledhje me publikun, ka qenë vetëm pjesëmarrëse në dy dëgjesat publike të zhvilluara nga sipërmarrësi.

*Në përgjigje të pyetjes kryesore të auditimit:* “A është kryer siç duhet planifikimi i projektit për menaxhimin dhe përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë Fier në ndërtimin e impiantit të përpunimit dhe djegies së mbetjeve të ngurta për prodhim energjie në Bashkinë Fier?” grupi i auditimit konkludoi në mesazhin:

***Në zhvillimin e projektit për incenerimin e mbetjeve urbane për përfitim të energjisë, palët e interesit janë konsultuar në mënyrë formale, si publiku, i cili ka qenë vazhdimisht kundër, dhe institucionet zyrtare lokale të cilat nuk kanë dhënë mendimin e tyre profesional dhe nuk kanë përfaqësuar publikun e tyre, por projekti është vendosur për tu zhvilluar pavarësisht kësaj situate. Projekti është ngritur dhe po ecën përpara duke krahasuar vetëm 2 alternativa, atë ekzistente pa projekt dhe atë që mund të jetë sipas këtij projekti. Gjatë zgjedhjes së kësaj alternative nuk janë konsideruar alternativa të tjera të mundshme, duke anashkaluar proceset e ripërdorimit dhe riciklimit të mbetjeve, e duke mos zbatuar kështu Strategjinë Kombëtare të Mbetjeve.***

Duke marrë parasysh problematikën në rang kombëtar të menaxhimit të mbetjeve dhe mungesës së një strukture përgjegjëse në mënyrë direkte për mbetjet, KLSH rekomandon krijimin e një Enti Rregullator të Menaxhimit të Mbetjeve për përcaktimin e një tarife, në zbatim të parimit “Ndotësi paguan” për hedhje, PAYT (pay as you throw) për sasi e për tipologji mbetje. Në të duhet të jenë të përfaqësuar qeveria, pushtetet lokale, shoqatat e sipërmarrjeve të sektorit, Dhomat e Tregëtisë, shoqëria civile, ekspertët mjedisorë, bota akademike, etj. Ai duhet të financohet

pjesërisht nga buxheti i shtetit dhe pjesërisht nga grupet e interesit dhe pushtetet lokale dhe në përbërje të bordit, sipas pjesëmarrjes në buxhet, përvç "aksionerëve", të garantohet përfaqësimi edhe i shoqërisë civile dhe ekspertëve mjedisorë. Bordi emëron administratorin. Njëkohësisht, ky Ent i Menaxhimit të Mbetjeve administrohet nga Autoriteti Kombëtar. Enti duhet të ketë si objektiv vetëfinancimin progresiv, nëpërmjet të ardhurave nga procesi i menaxhimit të mbetjeve dhe nga taksa e ambllazhit.

Për një periudhë afatmesme deri në vitin 2025, kur mendohet pranimi në BE, të jetë krijuar Agjencia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve, sipas një koncepti modern dhe apolitik (me një bord drejtues të gjerë dhe të hapur kundrejt përfaqësuesve të grupeve të interesit, botës akademike, ekspertëve, etj.), që do të shërbejë si një Ent Rregullator dhe administrues i të gjithë procesit.

Nëpërmjet politikave të rimbursimit ose financimit shtetëror të realizohet dalja në treg e subjekteve të reja grumbulluese, ricikluese ose asgjësuese për të gjitha këto kategori mbetjesh.

Të hartohet Kodi mjedisor, ku të ripërcaktohet në kushtet aktuale pozicioni i së drejtës së mjedisit midis asaj penale, civile dhe administrative, me pikësynim që të ashpërsohet dhe të zgjerohet Kodi Penal me çështje mjedisi.

## V E N D O S A:

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit të Performancës, "**Menaxhimi i përpunimit të mbetjeve të ngurta në impiantin e Bashkisë Fier**" të ushtruar në Ministrinë e Infrastruktues dhe Energjisë, Minsitrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe Bashkinë Fier.

**II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave për sa vijon:

Në përgjigje të pyetjes së auditimit: **A është hartuar në përputhje me strategjinë, kuadrin ligjor e rregullator të fushës kontrata me operatorin ekonomik?**

- Përcaktimi i sheshit si për ngritjen e landfillit dhe për atë të incineratorit kërkon një studim krahasimor të shesheve, duke ponderuar sipas kritereve dhe standardeve, jo më pak se 10 sheshe, duke vijuar deri në zgjedhjen e tre më të mirëve, për të cilët të hartohen studime efektive të parafizibiliteteve, dhe në fund, për më të mirin për të cilin të kryhen studime edhe më të kompletuara.
- Është kryer Studimi i fizibilitetit për "Impiantin e djegies së mbetjeve të ngurta urbane dhe prodhimin e energjisë në Qarkun Fier", dhe landfill-in për vendin e parë të përcaktuar, Portëz dhe Studimi i Fizibilitetit për në vendin e dytë, i cili nuk ka të shënuar datën e kryerjes së studimit.
- Është përgatitur Raporti teknik për projekt-propozimin dhe ndërtimin e "Impiantin e djegies së mbetjeve të ngurta urbane dhe prodhimin e energjisë në Qarkun Fier" (Incineratorin), dhe landfillin e depozitimit të mbetjeve nga kompania "Integrated Technology Waste Treatment Fier" sh.p.k. dhe është ri-përgatitur Raporti teknik në Janar, 2017, titulluar "Informacion për ndërveprimin me mjedisin" të Impiantit të djegies së mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimit të energjisë prej tyre", për

vendodhjen tjetër në fshatin Mbrostar (ku nuk përmenden 3-fshatrat që kanë bërë petitionin e që janë: Vërri, Vajkan dhe Kallm).

- VNM-ja - Është përgatitur VNM-ja e ndërtimit të Impiantit të djegies së mbetjeve të ngurta urbane dhe prodhimin e energjisë në Qarkun Fier”, për vendodhjen e parë, në fshatin Portëz (Gusht, 2016) dhe VNM-ja e thelluar për në vendin e ri-spastuar në Mbrostar (Prill, 2017).
- VNM-ja e thelluar - Me kërkesë të administratorit të kompanisë “Integrated Technology Waste Treatment Fier” sh.p.k., me shkresën nr. 284, date 12.01.2017, AKM-ja me shkresën nr. 415, datë 23.02.2017, drejtuar administratorit të kompanisë “ITWT-Fier”, njofton vazhdimin e procedurës për VNM të thelluar, dhe Kompania “ITWT-Fier”, me shkresën e datës 31.03.2017 (nr. Prot. 2848) i kërkon MM-it aplikimin e VNM-së së thelluar, kur MM-it me shkresën nr. 2848, datë 7.04.2017, drejtuar AKM-së i dërgon asaj sugjerime teknike për zhvillimin e VNM-së së thelluar dhe ndërkohë VNM-ja e thelluar paraqitet e përfunduar në Prill 2017, e përgatitur për disa ditë kur afati minimal është për 3-muaj dhe MM-it në datën 8.05.2017 lëshon “Deklaratën Mjedisore” (Vendimi nr. 18 me nr. Identifikimi 294);
- MM-it, me shkresën nr. 284/1, datë 26.01.2017, drejtuar AKM-së, jep mendime dhe sugjerime që të zhvillohet procedura e thelluar e VNM-së por e ndarë veçmas për incineratorin dhe veçmas për landfill-in, pasi janë dy veprimtari të ndryshme.VNM-ja e thelluar është dorëzuar në MM-it në Prill, 2017, por në tabelën e pasqyrimin të kuotave të metimeve të gazeve dhe lëngjeve në mjedis, janë dhënë shifrat e normave të Direktivës së BE-së 2000/76/EC dhe jo kuotat e pritshme të emetimeve të gazeve dhe lëngjeve nga impianti i Fierit gjë që nuk jep garanci për ndotjen mjedisore. Kjo nuk krijon bindjen se cilat janë ndikimet reale dhe rreziqet mjedisore nga ndërtimi i këtij impianti (incineratori).
- Nga dokumentacioni ka rezultuar se, megjithëse ka disa data takimesh dhe foto për prezantimin e impiantit në Fier, nuk rezulton se janë bërë realisht 3 konsultimet me banorët e komunitetit përreth, respektivisht me tre fshatrat e Qarkut Fier (Vajkan, Vërri, Kallm) nga AKM-ja dhe DRM Fier.
- Në Raportin teknik duke iu referuar kuadrit ligjor të cituar dhe Direktivat e BE-së që kanë të bëjnë me menaxhimin e MNU-ve nuk përmendet Konventa e Aarhus-it për konsultimet me publikun dhe dhënien e informacionit të palëve të interesuara dhe publikut dhe përfshirja e aktorëve të interesuar në vendimmarje, respektivisht të komunitetit të tre fshatrave (Vërri, Vajkan, Kallm);
- Nuk reflektohen në dokumentacionin bazë si për incineratorin dhe landfill-in përveç kuadrit ligjor kombëtar dhe Direktivave të BE-së (respektivisht Direktiva 2000/76/EC: “Për djegien e mbetjeve-incineratorët”, Direktiva e PE-së 2010/75/EU: “Për standartet e emetimeve ndotëse nga shkarkimet industriale të impianteve të këtij lloji siç janë dhe incineratorët e djegies së mbetjeve” dhe Direktiva e Këshillit të BE-së 75/442/EEC, “Për mbetjet”, datë 15.07.1975 ku përcaktohen kategoritë e mbetjeve të ngurta dhe të lëngshme dhe përcaktohen standartet e emetimeve ndotëse nga shkarkimet industriale të impianteve të këtij lloji siç janë dhe incineratorët e djegies së mbetjeve dhe Direktiva e Këshillit të BE-së 91/689/EEC, 12.12. 1991 “Për mbetjet e rrezikshme”.

- Konçesionari mund të lerë peng ose të vendosë si garanci tek huadhënësi vetëm të drejtën e përdorimit të shesheve dhe të aseteve që i përkasin atij, por nuk mund të tjetërsojë dhe të lerë peng pasurinë e paluajtshme me pronarë shtetin.
- Kontrata e nënshkruar nuk ka përcaktuar saktë mbylljen e afateve financiare nga ana e Konçesionarit. Nevojitet përcaktimi i një afati më të gjatë dhe sipas ligjit, pasi në të kundërt mosçaktimi i këtij afati do të sillte vonesa në realizimin e projektit.
- Kontrata e nënshkruar nuk ka përcaktuar saktë vendin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve që mund të lindin gjatë periudhës së zbatimit të kontratës deri në përfundim të saj. Ndërkohë që neni 18.2.1 i kësaj kontrate përcakton se secila palë mund t'i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Neni 46 i ligjit 125/2013 i ndryshuar përcakton se Kontratat e koncesionit/partneritetit publik privat rregullohen nga ligjet e Republikës së Shqipërisë. Neni 1 i Konventës Evropiane mbi Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar të Gjenevës datë 21.04.1961, në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar, parashikon se subjektet duhet të kenë selitë e tyre në dy vende të ndryshme.
- Autoriteti Kontraktor është i detyruar që gjatë fazës së hartimit të dokumenteve të tenderit të përcaktojë saktë dhe sipas ligjit kushtet për rregullat e të drejtat e pronësisë së tokës ku do ndërtohet Impianti i Trajtimit të Mbetjeve Urbane dhe i Prodhimit të Energjisë në Qarkun Fier.
- Autoritet Kontraktor dhe Komisioni i ngritur për Dhënie e Koncesionit/Partneritet Publik Privat, duhet që në kontratë të pasqyrojë të gjitha nenet që janë përcaktuar në Dokumentet Standarde të Procedurës Përzgjedhëse.
- Përzgjedhja e Supervisorit nga AK është bërë në mënyrë të gabuar. Mbikëqyrësi i punimeve emërohet nga investitori, duhet të jetë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit që do të drejtojë.
- Përcaktimi saktë i Tenderit ka të bëjë me konceptin se çfarë kuptojmë me një marrëveshje mes palëve dhe detyrimet që rrjedhin mes tyre. "Koncesioni" është një marrëveshje me interes financiar, objekt i së cilës është kryerja e punimeve dhe sigurimi i shërbimeve. "Partneritet Publik Privat" nënkupton një marrëveshje bashkëpunimi afatgjatë, të rregulluar me kontratë ndërmjet autoritetit kontraktues, domethënë partnerit publik, dhe një ose më shumë operatorëve ekonomikë.

#### Në përgjigje të pyetjes së auditimit: **A justifikohet financiarisht ky projekt?**

- Analiza kosto-përfitim është kryerja e vlerësimit të një projekti apo veprimi të planifikuar duke përcaktuar se çfarë vlere neto do të ketë ai për kompaninë ose investitorin. Në thelb, një analizë kosto-përfitimi gjen vlerëson, dhe llogarit të gjithë faktorët pozitivë. Këto janë përfitimet. Më pas ajo identifikon, vlerëson dhe zbret të gjitha shpenzimet. Diferenca e përfitimeve dhe shpenzimeve ose kostove tregon nëse ky projekt apo vepër e planifikuar është e këshillueshme.
- Analizat ekonomike në përgjithësi dhe AKP-ja në veçanti mund t'i japin politikëbërësve informacion të vlefshëm për marrjen e vendimeve të duhura.
- Llogaritja e Vlerës Totale neto për secilën alternativë të marrë në shqyrtim është bërë duke ndjekur një serë hapash. Hapi i parë është identifikimi i kostove dhe



përfitimeve financiare, sociale e mjedisore. Hapi i dytë është llogaritja e kostove dhe përfitimeve financiare, sociale e mjedisore me anë të metodës së vlerës aktuale neto me normën e skontimit 3%. Hapi i tretë është mbledhja e kostove dhe përfitimeve për të gjetur Vlerën Totale Neto të secilës alternative dhe hapi final është krahasimi i vlerave totale neto të të katërt alternativave me qëllim përzgjedhjen e alternativës më të mirë.

- Në këtë auditim, Analiza Kosto-Përfitim bazohet mbi kushtet lokale të Bashkisë Fier dhe karakteristikave specifike të mbetjeve urbane.
- Arsyeja përse janë zgjedhur metoda e landfillit të thjeshtë, metoda e landfillit me riciklim dhe metoda e incineratorit është sepse këto metoda bazohen në Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve dhe Ligjit Nr. Ligjin Nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve.
- Analiza Kosto-Përfitim u përdor me sukses për llogaritjen dhe krahasimin kostove dhe përfitimeve ekonomike-social dhe mjedisore të katër metodave të marra në shqyrtim.
- Nga krahasimi i katër alternativave, dampa ekzistuese paraqet situatën më të rëndë duke qenë se kostot janë të larta dhe përfitimet janë zero.
- Metoda e landfillit me riciklim renditet si alternativa me leverdisshmëri ekonomike më të lartë për t’u vënë në zbatim, pasi kjo metodë garanton të ardhura nga shitja e materialeve për riciklim dhe kompostim, si dhe përfitime nga shmangia e dëmeve social e mjedisore.

**Në përgjigje të pyetjes së auditimit: A janë konsultuar institucionet zyrtare lokale si palë e interesit publik para dhënies së lejes mjedisore nga AKM?**

- Në mungesë të mendimeve profesionale të institucioneve zyrtare lokale dhe jo vetëm, është e pamundur:
  - të krijohet një opinion i qartë në lidhje me impaket pozitive e negative të këtyre projekteve;
  - të ketë qartësi dhe informacion të saktë për publikun në lidhje me dobishmërinë e këtyre projekteve.
- Në mungesë të një studimi mjedisor për vlerësimin e përzgjedhjes së alternativës më të mirë nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe Bashkia Fier, nuk është e qartë arsyeja e përzgjedhjes së djegies së mbetjeve duke anashkaluar proceset e ripërdorimit dhe riciklimit të tyre.
- Përzgjedhja e metodës për incinerimin e mbetjeve pa u kryer më parë proceset e ripërdorimit e riciklimit nuk është në linjë me zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Mbetjeve.

**Në përgjigje të pyetjes së auditimit: A janë kryer konsultimet me publikun gjatë fazës së planifikimit të impiantit?**

- Konsultimet me publikun janë kryer në mënyrë formale, të pakta në numër, aq sa mjaftojnë për të qenë pjesë e dokumentacionit në dosje, me qëllim vijimin e procedurës së marrjes së lejes mjedisore.

- AKM ka pajisur me Deklaratë Mjedisore projektin për ndërtimin e incineratorit dhe nuk ka pajisur projektin mbështetës për ndërtimin e landfillit ndërkohë që për të dy projektet ka filluar puna për ndërtimin e tyre, pavarësisht kundërshtimit të hapur nga ana e banorëve, duke vepruar kështu në kundërshtim me Kreun II, paragrafi 4.2 i VKM nr. 247, datë 30.04.2014.
- Procesi për të dy projektet nuk ka qenë transparent, gjë që konstatohet dhe nga refuzimi i firmës nga ana e banorëve pjesëmarrës në dëgjesa publike, të cilët janë totalisht të paqartë për procedurat.

Në përgjigje të pyetjes së auditimit: **A është hartuar në përputhje me strategjinë, kuadrin ligjor e rregullator të fushës kontrata me operatorin ekonomik?**

**Rekomandoj:**

1. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit si Autoriteti Kontraktor të marrë masa për ndryshimin e Kontratës me anë të një Aneksi, ku të përcaktohet përfundimi i investimit sipas afatit maksimal prej 12 muaj, bazuar në shkronjën (b), të pikës 1 të nenit 3 të ligjit 125/2013 “Për Konçesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, i ndryshuar.

*Menjëherë*

2. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit si Autoritet Kontraktor të marrë masa për ndryshimin e Kontratës Konçesionare, duke përcaktuar si organin kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve Gjykatën Administrative të Republikës së Shqipërisë.

*Menjëherë*

3. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit si Autoritet Kontraktor të marrë masa për ndryshimin e Kontratës për përcaktimin e saktë të bazës mbi të cilën rregullohen të drejtat e pronësisë së tokës ku do ndërtohet Impianti i Trajtimit të Mbetjeve Urbane dhe i Prodhimit të Energjisë në Qarkun Fier. Bazuar në ligjin Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat Nr. 125/2013 i ndryshuar, neni 38 “E Drejta e Pronësisë” pika 2.

*Menjëherë*

4. Pasi të përfundojë proceduara e marrjes së tokës dhe lejes së ndërtimit për territorin e venddepozitimit të ri që okupohet nga ndërtimi impiantit dhe landfillit, në njësinë administrative Mbrostar Ura, projekti i landfillit të paraqitet për ri-shqyrtim të dhënies së lejes mjedisore të këtij impianti nga organet vendimë marrëse.

*Menjëherë pas marrjes së tokës dhe lejes së ndërtimit për landfillin*

5. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit si Autoritet Kontraktor të marrë masa për pasqyrimin në Kontratën Koncesionare të neneve: 4, 6, 13, 18, 20, 21 dhe 25, sipas Dokumenteve Standarde të Procedurës. Bazuar në nenin 27 pika 3 e ligjit nr. 125/2013 dhe ligjin nr. 77/2015 “Për Koncesionet dhe Partneritet Publike Private”.

## ***Menjëherë***

6. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të marrë masa për përzgjedhjen e Supervizorit sipas ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ndryshuar me Ligjin nr. 20/2013, datë 14.02.2013 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”.

## ***Menjëherë***

7. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit si Autoritet Kontraktor të marrë masa menjëherë për të përcaktuar saktë Kontratën e Tenderit si Partneritet Publik Privat.

## ***Menjëherë***

8. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në cilësinë e AK, të marrë masa për rritjen e kapaciteteve profesionale dhe veçanërisht atyre institucionale në vendimmarrje për caktimin në përbërjen e Komisionit për Dhënien me Konçesion me Partneritet Publik Privat, duke përfshirë specialistë dhe ekspertë të mirëfilltë të fushës, me qëllim zbatimin me rigorozitet dhe përgjegjshmëri të legjislacionit në fuqi, shmangien e abuzivizmit dhe favorizimit të operatorëve ekonomikë në vendimmarrjen e Komisionit për Dhënien me Koncesion / Partneritet Publik Privat.

## ***Vazhdimisht***

9. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në cilësinë e AK, nëpërmjet Drejtorisë Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore, për evidentimin e përgjegjësive.

***Brenda muajit Mars 2019***

10. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nëpërmjet Drejtorisë Juridike, të marrë masat e nevojshme për publikimin e prokurimeve me vlerë mbi kufijtë e lartë monetar, në të paktën një gazetë me shpërndarje në Evropë, në përputhje me kriteret e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

***Brenda muajit Mars 2019***

Në përgjigje të pyetjes së auditimit: **A justifikohet financiarisht ky projekt?**

### **Rekomandoj:**

1. Në çdo rast para se të fillohet me një trajtim të caktuar të jetë kryer më parë një analizë kosto-përfitim (AKP), si një veprim i planifikuar që në thelb, gjen, vlerëson dhe llogarit të gjithë faktorët pozitivë dhe më pas identifikon, vlerëson dhe zbrit të gjitha shpenzimet, ku diferenca e përfitimeve dhe shpenzimeve ose kostove tregon nëse ky projekt apo veper e planifikuar është e këshillueshme.

## ***Vazhdimisht***

2. Në të gjitha aspektet e planifikimit dhe buxhetimit, në projekte që mund të analizohen me një shkallë mjaft të lartë të saktësisë, të tilla si menaxhim mbetjesh, ujësjellës, në programet që përfshijnë një shkallë të madhe të të dhënave

subjektive, të kryhet AKP, ku çdo projekt publik të kalojë një test të analizës kosto-përfitim para se të mund të vihet në zbatim.

***Vazhdimisht***

3. Bashkia Fier të punojë për të zbatuar programe që synojnë parandalimin dhe minimizimin e mbetjeve në burim.

***Vazhdimisht***

4. Bashkia Fier para se të dërgojë mbetjet në landfill të kryejë procesin e Kompostimit si një lloj procesi që përfshin dekompozimin biologjik të materialeve organike për prodhimin e qëndrueshëm të prodhimeve humus.

***Menjëherë pas vënies në funksionim të incineratorit dhe landfillit***

**Në përgjigje të pyetjes së auditimit: A janë konsultuar institucionet zyrtare lokale si palë e interesit publik para dhënies së lejes mjedisore nga AKM?**

**Rekomandoj:**

1. Para dhënies së lejes mjedisore nga AKM për fazën e vënies në funksionim të incineratorit dhe të dyja fazat e si ajo e ndërtimit dhe vënies në funksionim të landfillit të jepet nga institucionet lokale Bashkia Fier, DRM Qarku Fier mendimi i tyre, në bazë të një vlerësimi profesional të secilit projekt.

***Menjëherë***

2. Në rastin e një vendimmarrjeje, për ndërtimin e incineratorit për djegien e mbetjeve dhe për prodhim energjie, siç është rasti në zbatim e sipër, rekomandojmë që ky incinerator të marrë jo më tepër se 30-40% të mbetjeve urbane duke qenë i destinuar vetëm për mbetjet e vendit. Nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në zbatim dhe të Strategjisë Kombëtare të Mbetjeve të gjendet mënyra për të mos anashkaluar proceset e ripërdorimit dhe riciklimit të mbetjeve vetëm me qëllimin e krijimit të volumeve sa më të mëdha për djegie. Një mënyrë mund të jetë dhe përfshirja në këtë projekt e bashkive të tjera jashtë Qarkut të Fierit, duke mbledhur kështu mbetjet e dy tre Qarqeve, si p.sh. atë Berat dhe Vlorë, përveç atij të Fierit, të cilat nuk e kanë të zgjidhur problematikën e menaxhimit të mbetjeve.

***Vazhdimisht***

3. Bashkia Fier dhe Bashkitë e tjera pjesë e këtij projekti të punojnë për të zbatuar programe që synojnë parandalimin dhe minimizimin e mbetjeve qysh në burim, duke vijuar me ndarjen nëpër pika të ndryshme grumbullimi dhe shitjen për çdo lëndë të kthyer në lëndë të parë për ripërdorim ose riciklim. Mbetja e destinuar për asgjësim final t'i nënshtrohet procesit të rikuperimit të energjisë, dhe mbetja finale e pa biodegradueshme i nënshtrohet procesit të landfillit pranë teknologjisë së incinerimit sikundër është menduar.

***Vazhdimisht***

Në përgjigje të pyetjes së auditimit: **A janë kryer konsultimet me publikun gjatë fazës së planifikimit të impiantit?**

**Rekomandoj:**

1. Gjatë fazës së ndërtimit të landfillit, para dhënies së deklaratës mjedisore, të kryhen dëgjesa me publikun nga Bashkia Fier ose institucione të varësisë së saj, me qëllim informimin e tyre në lidhje me projektin.

***Menjëherë***

2. Në rastin e një vendimmarrjeje për vënien në punë të secilit nga projektet, për ndërtimin e një incineratori për djegien e mbetjeve për prodhim energjie dhe për landfillin, të bëhen 3 konsultimet me banorët e komunitetit përreth, respektivisht me tre fshatrat e Qarkut Fier (Vajkan, Vërri, Kallm) nga AKM-ja përmes DRM-së Fier dhe të merren mendimet e tyre në lidhje me vënien e tyre në funksionim dhe mendimi i tyre të pasqyrohet në VNM-në e thelluar. Për këtë nevojitet bashkëpunimi i Bashkisë Fier me AKM e DRM Fier. Nëse bihet dakord me komunitetin të rifillojë puna për përmirësimin e dokumentacionit.

***Menjëherë***

3. Bashkia Fier dhe Këshilli Bashkiak të luajnë rolin e tyre në lidhje me informimin e publikut për projektet në fjalë, me qëllim ruajtjen e një procesi sa më transparent, ku qytetarët të ndjehen pjesëmarrës aktivë, nëpërmjet mbajtjes së mbledhjeve informuese dhe kërimit të opinionit të tyre.

***Menjëherë dhe vazhdimisht***

4. AKM të marrë parasysh mendimin e banorëve të zonës ku do të ndërtohet projekti i impiantit të djegies dhe landfillit për depozitimin e hirit, gjatë procedurës së shqyrtimit të dokumentacionit, para dhënies së lejes mjedisore për secilin projekt.

***Menjëherë***

5. Të përmirësohet Raporti Teknik duke iu referuar përveç kuadrit ligjor të cituar dhe Direktivave të BE-së që kanë të bëjnë me menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane dhe Konventës së Aarhus-it për konsultimet me publikun, dhënien e informacionit të palëve të interesuara dhe publikut si dhe përfshirjen e aktorëve të interesuar në vendimmarrje, respektivisht të komunitetit të tre fshatrave (Vërri, Vajkan, Kallm).

***Menjëherë***

6. Në tabelën e pasqyrit të kuotave të emetimeve të gazeve dhe lëngjeve në mjedis, të jepen kuotat e pritshme të emetimeve të gazrave dhe lëngjeve nga incineratori sipas normave të Direktivës së BE-së 2000/76/EC, gjë që jep garanci për mosndotjen mjedisore dhe krijon bindjen tek publiku se cilat janë ndikimet reale dhe rreziqet mjedisore nga ndërtimi i këtij impianti (incineratori).

***Menjëherë***

7. Lind nevoja e rihartimit të VNM-së së thelluar duke iu referuar përveç kuadrit ligjor shqiptar dhe Diraktivave BE-së që kanë të bëjnë me menaxhimin e MNU-ve dhe Konventa e Aarhus-it.

**Menjëherë**

8. Të reflektohen si referencë në dokumentacionin bazë si për incineratorin dhe landfill-in përveç kuadrit ligjor kombëtar dhe Direktivave të BE-së (respektivisht Direktiva 2000/76/EC: "Për djegien e mbetjeve-incineratorët", Direktiva e BE-së 2010/75/EU: "Për standartet e emetimeve ndotëse nga shkarkimet industriale të impianteve të këtij lloji siç janë dhe incineratorët e djegies së mbetjeve" dhe Direktiva e Këshillit të BE-së 75/442/EEC, "Për mbetjet", datë 15.07.1975 ku përcaktohen kategoritë e mbetjeve të ngurta dhe të lëngshme" ku jepen standartet e emetimeve ndotëse nga shkarkimet industriale të impianteve të këtij lloji siç janë dhe incineratorët e djegies së mbetjeve dhe Direktiva e Këshillit të BE-së 91/689/EEC, 12.12. 1991 "Për mbetjet e rrezikshme"; Konventa e Bazelit, datë 29.06.1999: "Për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme".

**Menjëherë**

9. Të merret si referencë ligjore dhe të plotësohen detyrimet që rrjedhin prej Konventës së Aarhus-it e v.1998, Aarhus, Danimarkë, ratifikuar me Ligjin nr.8672, datë 26.10.2000 "Për të drejtën e publikut për tu informuar paraprakisht për problemet mjedisore dhe konsultimet si dhe pjesëmarrjen në vendimmarrjen për çështjet mjedisore dhe të drejtën e qasjes në mbrojtjen ligjore në rast të shkeljes të së drejtës së tij për një mjedis të pastër."

**Menjëherë**

10. Për rifillimin e punës dhe lejimin e ndërtimit të këtij impianti nevojitet të kryhen dhe një sërë studimesh të tjera si:

- Studim fizibiliteti (për vendodhjen e re në fshatin Mbrostar, NJA: Mbrostar Ura, në afërsi të fshatrave: Vërri, Vajkan dhe Kallm);
- Të ribëhet VNM-ja e thelluar (përfshi 3-konsultime me publikun-banorët përreth);
- Të bëhet Plani i Komunikimit Publik për përfshirjen e komunitetit lokal në këtë vendimmarrje dhe të bëhen 3-konsultime me publikun, respektivisht me komunitetin përreth (fshatrat: Mbrostar, Vërri, Vajkan, Kallm) nga AKM-ja përmes ARM-së, Fier, sipas Ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
- Plani i Menaxhimit të Mbetjeve që gjeneron impianti;
- Plani i Monitorimit Mjedisor dhe rishikimi i vazhdueshëm i tij;
- Projekti i depozitimit të mbetjeve urbane, skorjeve dhe hirit, ku përlllogaritet se gjatë një viti do të gjenerohen rreth 13,400 ton mbetje të ngurta;
- AKM të vendosë një stacion monitorimi në zonën e projektit për monitorimin e ajrit dhe të dhënat e tij duhet të publikohen dhe të jenë të aksesueshme online;
- Grupet e interesit, AKM, Operatori i Impiantit, Bashkia Fier, ARM dhe organizatat e shoqërisë civile, me një marrëveshje të përbashkët, duhet të bien dakord për aksesin e të dhënave të monitorimit dhe kryerjen e inspektimeve të përbashkëta;

- Strukturat e shëndetësisë duhet të kryejnë një kontroll (depistim) të popullsisë brenda zonës së impiantit (rreth 6 km) në lidhje me sëmundjet respiratore.

***Brenda muajt Mars 2019 dhe të ndiqen në vazhdimësi***

11. Për të ardhmen në rast ndërtimi të impiantit, vëmendja e autoriteteve monitoruese të fokusohet në zbatimin e Planit të Menaxhimit të Mjedisit dhe verifikimin e sistemit të monitorimit të shkarkimeve në ajër të impiantit dhe ndikimeve të mundshme të shkarkimeve në ajër dhe në kulturat bujqësore të veçanta në afërsi të impiantit.

***Në vazhdimësi***

Raporti Përfundimtar i Auditimit bashkë me vendimin i përcillet subjekteve të përfshira në auditim, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkisë Fier dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, si dhe Kyesisë së Kuvendit të Shqipërisë dhe Komisionit të Ekonomisë.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Performancës.

### **Grupi i auditimit**

Artur HASANBELLIU  
Keida MUÇA  
Sazan GURI (ekspert i jashtëm)  
Mehmet METAJ (ekspert i jashtëm)

---

**Bujar LESKAJ**

**KRYETAR**

